



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.4.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016” (*Komisioni përgjegjës*)
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021” (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Tatiana Piro, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Rrahman Rraja, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Nusret Avdulla dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Luljeta Bozo, Flamur Hoxha dhe Fatjon Veizaj.

Të ftuar:

Enkelejda Muçaj – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Irena Malolli – Drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Përshëndetje!

Në rendin e ditës së sotme kemi si pikë të parë projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016”.

Relator është zoti Laert Duraj.

Pikë e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi dhe miratimi i draftrezolutës për veprimtarinë e ERE-së për vitin 2021.

Relator është zoti Anduel Tahiraj.

Të ftuar për pikën e parë kemi zëvendësministren, zonjën Enkelejda Muçaj, zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe zonjën Irena Malolli, drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave.

Fillojmë me pikën e parë.

Fjala për zëvendësministren.

Enkelejda Muçaj – I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë,

Kemi kënaqësinë që në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë t’ju paraqesim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016”.

Ky detyrim lind në bazë të nenit 25 të konventës së kësaj organizate. Shqipëria këtë vit feston 100-vjetorin e anëtarësimit në këtë institucion. Më 1 mars të vitit 1922 Shqipëria është bërë anëtare e kësaj organizate, e cila rregullon marrëdhëniet ndërshtetërore për shërbimin postar.

Ky angazhim ndodh sa herë që ka ndryshime në dokumentet bazë, dhe sipas projektligjit të parashikuar prej jush, Kushtetutës së Bashkimit të Përbotshëm Postar, Konventës së Përbotshme Postare, Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare, Rregullave të Procedurave të Kongreseve, si dhe Rregullores së Përgjithshme të Bashkimit të Përbotshëm Postar.

Ndryshimet në përgjithësi kanë karakter të harmonizimit të termave, shtimit të termave të reja, rregullimit të tarifave në marrëdhëniet ndërmjet operatorëve të nderuar, duke mos sjellë asnjë detyrim për buxhetin e shtetit. Pra, pranë jush është paraqitur paketa e plotë,

nuk është proceduar me amendime në kuptimin e teknikës legjislative, por, siç ka ndodhur edhe në vitet e mëparshme, kur ka pasur ndryshime të këtyre akteve, janë paraqitur si ndryshime të një trupi, univoke, brenda akteve në të cilat Shqipëria aderon si e tillë në tërësinë e saj.

Në mënyrë të përmbledhur ky është parashtrimi ynë paraprak.

Mbetemi në dispozicion për çdo pyetje që mund të kenë anëtarët e nderuar.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Fjala për relatorin, zotin Duraj.

Laert Duraj – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Përshëndetje, të nderuar të ftuar!

Është kënaqësi që më jepet mundësia të relatoj për ratifikimin e vendimeve të kongresit, ashtu dhe për çdo gjë që ka të bëjë me postën, që mund të sjellin, në një mënyrë, apo në një tjetër, një hap apo zhvillim pozitiv në sektorin e shërbimit postar.

Siç e përmendi edhe zëvendësministrja, kongresi është organi më i lartë i UPU-së, një nga organizatat më të mëdha në botë me 192 anëtarë. Si organi më i lartë, çdo vendim që rregullon marrëdhëniet mes operatorëve postarë, kalon nëpërmjet këtij kongresi dhe vjen si rrjedhojë e shumë analizave dhe diskutimeve të gjata, pasi për vetë natyrën e shërbimeve postare, dinamika e marrëveshjeve dhe e komunikimeve me njëri-tjetrin është shumë intensive. Në këtë kuptim, kongreset janë të zakonshme, siç është rasti i Kongresit të Stambollit dhe i kongreseve të tjera të jashtëzakonshme.

Për sa u përket përvojave të mëparshme, duhen rreth 3 vjet pas mbarimit të kongresit që vendimet të ratifikohen në parlamentet përkatëse. Kur merret vendimi, vendi anëtar shpreh dakordësinë e tij nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar dhe Shqipëria e ka dhënë dakordësinë e saj në këtë rast. Ky është një veprim formal, i cili është një lloj detyrimi që Shqipëria e ka nga anëtarësia, megjithatë, koha e paraqitjes më duket disi vonë, por besoj se justifikohet me kohët e vështira që kemi kaluar prej pandemisë.

Dua t'ju bëj me dije se çfarë është vendosur në Kongresin e Stambollit, i cili ka përcaktuar, në një farë mënyre, kalimin në epokën e re të digjitalizimit të shërbimit postar në botë dhe ka pasur në fokusin e vet ndryshimet redaktuese, me qëllim harmonizimin e terminologjisë me pjesën tjetër të dokumenteve të UPU-së, sepse 192 organizata me shumë shërbime e kanë pasur të nevojshme të harmonizojnë termat; janë futur përkufizime të reja, sepse për shërbimet *iKomerci* ka pasur terminologji të re, e cila duhej shtuar në rregullore me marrëveshje mes palëve; ka pasur ndryshime me qëllim reflektimin e nevojave dhe

dinamikave të tregut botëror postar, siç janë ndryshimet në nenin e tarifave dhe peshave, sepse kjo është vërtet shumë dinamike.

Unë kam dëshirë të ndaj me ju edhe eksperiencën personale që pata në një kongres të mëvonshëm. Shpresoj që Kongresi i jashtëzakonshëm i Gjenevës, t'i kalojë të gjitha etapat, për të shkuar në parlament, pasi ka qenë një dialog ose debat shumë i fortë mes anëtarëve të UPU-së për tarifën e shërbimit postar. Shqipëria bën pjesë në zonën e katërt të kompanive të shërbimit postar publik. Këto kompani përfitojnë shumë nga tarifën e terminimit, ndaj qasja që ka pasur qeveria jonë dhe Posta Shqiptare në këtë kongres ka qenë shumë pozitive. Shpresoj që efektet për ekonominë shqiptare dhe postën të jenë sa më shpejt, pasi shërbimi postar, sidomos *iKomerçi*, është trend i ri.

Gjithashtu, ka pasur ndryshime në rregullat e procedurës, të cilat lidhen me procedurën e marrjes së propozimeve nga Këshilli i Administrimit ose Këshilli i Operacioneve Postare.

Ka pasur ndryshimet në Rregulloren e Përgjithshme të UPU-së, të cilat synojnë miratimin e parashikimit për një draftplan biznesi 4-vjeçar dhe përbërjen e komiteteve këshilluese. Në thelb duken burokratike, por ndryshimet që janë marrë në Kongresin e Stambollit, u kanë hapur rrugë edhe ndryshimeve të reja që pasuan në kongreset e mëvonshme, siç ka qenë ai i Addis Ababa-s në Etiopi, kongresi i jashtëzakonshëm i Gjenevës dhe kongresi i zakonshëm i këtij viti, që për herë të parë u mbajt *online*, ku një pjesë shkuan, ndërsa një pjesë ishin *online*, i cili solli të gjitha ndryshimet e këshillit dhe strukturës drejtuese të UPU-së me një qasje të re. Për herë të parë ajo drejtohej nga përfaqësuesi i Japonisë, i cili, për vetë natyrën, besoj se do t'i japë një hov të ri zhvillimit të *iKomerçit*.

Unë i ftoj kolegët që ta votojnë këtë draft.

Përfitoj nga rasti që të kërkoj edhe një diskutim për Postën Shqiptare, e cila, nisur edhe nga qasjet e kongresit, ka nevojë për një përkrahje më të madhe, sidomos për shërbimin universal. Një nga vendimet kryesore, që ka të bëjë me zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimit postar, ka qenë detyrimi i kompanive publike postare të ofrojnë akses në çdo pikë, për këdo dhe me tarifa të pranueshme, që janë bazat e një shërbimi publik postar.

Nga ana tjetër, kjo gjë i detyron qeveritë përkatëse të marrin masat e duhura për të rikompensuar tarifën apo shërbimet postare që kompanitë, në një farë mënyre, detyrohen t'i ofrojnë me humbje, siç bën Posta Shqiptare për shkak të detyrimit ligjor që ka për të qenë prezent kudo. Përfitoj nga momenti ta shtroj për diskutim edhe këtë shqetësim nga përvoja si drejtues, por besoj se do ta ndaj edhe me specialistët e ministrisë.

Gjithsesi, kjo është një temë e gjerë që del jashtë këtij diskutimi, por ju ftoj ta votojmë, besoj se është një ratifikim i thjeshtë me unanimitet, që t'u hapim rrugë edhe votimeve të kongreseve të mëvonshme, që janë shumë më konkrete në përfundimin e tyre dhe janë ndihmë e madhe për Postën Shqiptare.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Në fakt, ne presim të dorëzohet në Kuvend raporti i AKEP-it, pjesë e të cilit është edhe aktiviteti i Postës Shqiptare, për rekomandimet që kemi lënë, dhe do të shikojmë se si janë zbatuar detyrimet që ne kemi folur edhe për Postën Shqiptare. Besoj se do të kemi rast për të diskutuar edhe për shqetësimin tuaj.

Të nderuar kolegë, a ka pyetje apo diskutime?

Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Nuk kemi asgjë kundër për ta ratifikuar konventën, pa dyshim, sepse opozita ka dhënë gjithmonë mbështetje për sa u përket konventave.

Kam një pyetje sqaruese, sepse pjesa e postës është një fushë teknike, të cilën e kam pak të vështirë dhe nuk e njoh shumë mirë. Meqenëse ka lidhje me tarifat e operatorëve, një ndër gjërat që dua të më sqaroni është: këto tarifa, kur të rriten, meqenëse ratifikohet, kanë efekt jo vetëm te posta, por edhe tek operatorët e tjerë që kryejnë të njëjtin shërbim postar, sepse sot posta nuk është më monopol i vetëm i shtetit, por ka edhe operatorë të tjerë që operojnë, ndaj efektet e ratifikimit të kësaj konvente shtrihen edhe tek operatorët e tjerë. Në këto kushte, së pari, në terma nominal, për çfarë vlere bëhet fjalë? Pra, të jeni më sqarues dhe më në detaje edhe me fjalë të thjeshta, që ne t'i kuptojmë. Në ndryshim nga telefonia celulare, ku kemi një lloj familjariteti më shumë me *end user*-at, me operatorët e të tjerë, te pjesa e postës nuk kemi shumë familjarë ndaj do të doja të na e sqaronit.

E dyta, kur bëhen këto ratifikime, posta është shoqëri aksionere shtetërore, por nuk jeni në regjim monopoli, sepse ka edhe operatorë të tjerë që operojnë në Shqipëri, pra efektet e tyre shtrihen edhe tek operatorët e tjerë. Të lutem, na sqaroni, a keni bërë ndonjë diskutim me operatorët, a keni marrë një mendim për këto probleme?

Për këtë marr shkas nga çfarë deklaroi kolegu Duraj, që e njeh fushën, i cili tha: “Në disa raste posta mund të ketë edhe efekte negative financiare për efekt të ...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e vë në dyshim, e pranoj faktin që mund të mos jem i saktë, por nëse këto tarifa kanë edhe kushte, që mund të vendosin në pozitë të disfavorshme operatorët e tjerë, është e rëndësishme të na sqarohet në mënyrë të detajuar se si funksionon.

E dyta, a diskutohen këto konventa me operatorët e tjerë para se të sillen në parlament, apo nuk është praktikë pune, sepse në vetvete jeni edhe konkurrent njëri me tjetrin?

Arben Pëllumbi – Do të përgjigjeni ju apo relatori?

Laert Duraj – Pas Kongresit të Stambollit në Kongresin e Addis Ababa, tema kryesore që u diskutua ka qenë përfshirja në UPU e operatorëve privatë. Ka qenë rasti i DHL-së dhe FedEx-it, që insistuan shumë, por vendimi i kongresit ishte që ata të mos ishin pjesë e këtij sistemi. Pra, shërbimi postar publik vepron brenda vetes së vet me 192 anëtarë dhe nuk janë të përfshirë operatorët privatë. Tregu është shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimit të tarifave, por nuk ka institucion dialogues që merr dhe jep. Ka reflektime, por nuk ka komunikime të kësaj natyre.

Për sa u përket tarifave, të cilat u prekën te Kongresi i Gjenevës, jo aq shumë te Kongresi i Stambollit, mund të them se çdo operator publik postar ka detyrimin ligjor të orientojë tarifat përkatëse drejt kostove përkatëse, sidomos tarifat e shërbimit universal, që janë dërgimi i letrave, i pakove të vogla, shërbime standarde. Çdo kompani ka detyrimin t'i përfaqësojë me kostot përkatëse, ndaj Shqipërisë i dalin kostot ndryshe, Italisë ndryshe, Japonisë ndryshe e të tjera me radhë.

Ajo që është diskutuar dhe reflektohet për sa u përket ndryshimeve të tarifave, ka të bëjë më shumë me tarifat e interkonjeksionit, që do të thotë: sa merr një kompani shqiptare postare në këtë rast nga një pako e dërguar nga Japonia dhe sa merr nga një pako e dërguar nga Anglia e të tjera me radhë. Në të gjitha diskutimet që janë bërë, për një vend si Shqipëria, që është te brezi i katërt, çdo ndryshim i propozuar dhe i votuar në Kongresin e Gjenevës është pozitiv, sepse e rrit shumë pjesën që posta shqiptare merr nga terminimi. Posta Shqiptare ka qenë kompania e tretë që u lidh me sistemin e përbotshëm të dhënies së të dhënave, pra në kohë reale, që do të thotë nëse një pako nga Japonia i kushtonte dërguesit 10 euro, më parë Posta Shqiptare merrte 2 euro për terminim, ndërsa tani do të marrë 3 euro, 30%-40% më shumë të ardhura. Kjo është një lloj qasjeje që e kanë pasur fuqitë e mëdha si Amerika, Kina dhe Japonia për operatorët e vegjël, pasi edhe kostoja e terminimit janë është shumë e madhe. Pra, nëse më parë që do ta dërgoje me avion, kushtonte “X” dhe ta shpërndaje deri në pikën fundore “Y”, në përgjithësi vlera e ndarjes deri në pikën fundore është shtuar shumë, transporti, dërgimi i pakove dhe të gjitha me radhë ndërkohë dhe standardet janë rritur. Posta Shqiptare, për shkak se ka operuar vërtet mirë, ka përfituar nga kjo gjë.

Në përgjithësi, vendimet që merren në kongres, për sa i përket Postës Shqiptare që është dhe brezi i katërt, kanë qasje pozitive për të ardhurat, por për sa u përket tarifave që është një temë, që mund të diskutohet pafund, Posta Shqiptare i ka të bazuara te kostot.

Për të ndryshuar tarifën, është temë më vete, dhe për mua, si drejtues i atij institucioni, ka qenë shqetësim, mund të them, që në Postën Shqiptare nuk janë ndërruar tarifën këtu e 20 vjet, i cili është një problem shumë i madh, që duhet të diskutohet, siç e tha edhe zoti Pëllumbi, kur të diskutojmë për AKEP-in, pasi ka shumë diskutime. Praktikisht, tarifën, që janë në postë sot, mund të jenë, të paktën për shërbimin universal, të pandryshuara këtu e 20 vjet. Pra, nuk është reflektuar asnjë lloj norme inflacioni apo ndryshim çmimesh, apo gjëra të kësaj natyre. Irena i njeh jashtëzakonisht mirë, edhe më mirë se unë, pasi ka një jetë që merret me shërbime postare.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Nëse e kuptuam mirë edhe pyetjen që bëri zoti Bushati, pjesë e këtij kongresi janë vetëm operatorët publikë, jo operatorët privatë dhe vendimet që ne marrim sot kanë të bëjnë vetëm me Postën Shqiptare, jo me operatorët privatë, të cilët nuk kanë tarifën të rregulluara sipas këtij Kongresi?

Doni të thoni diçka?

Enkelejda Muçaj – Realisht, është vetëm për të plotësuar atë që i nderuari relator tha. Pra, në fund fare edhe bilanci i pagesave dhe ndryshimet e tarifave të këtij Kongresi, që ne po diskutojmë, pasi të 2 kongreset e jashtëzakonshme, edhe ky i vitit të katërt, të cilët u përmendën, janë pjesë e aderimit dhe ratifikimit në proces e sipër, nuk janë pjesë e shqyrtimit të këtij ratifikimi në kohë. Ka ardhur pak me vonesë për shkaqe administrative, e përmendi i nderuari relator faktin që pas kongresit të vitit 2016 ne vijmë me pak vonesë këtë herë, por sidomos për kongreset e jashtëzakonshme, që kanë marrë vendime dhe pikërisht për operatorët publikë, që u saktësua këtu dhe që ka edhe detyrimin për shërbim universal, nuk ka efekte të tjera në treg. Në fund fare, për bilancin e pagesave nga rritjet, sepse përgjithësisht bëhet fjalë për tarifa terminimi në shtetet respektive për shërbimin postar, Republika e Shqipërisë dhe Posta Shqiptare në përgjithësi rezultojnë të jenë pozitive, pasi bilanci i prurjeve me daljet e shërbimit postar janë gjithmonë në pozitiv për të ardhurat, pra për të ardhurat që marrim, pasi kuptohet që sasia e ardhur është gjithmonë më e madhe se sasia që del nga Republika e Shqipërisë. Pra, në këtë kuptim dhe në kuptimin tregtar Posta Shqiptare ka gjithmonë bilanc pozitiv dhe do të duam ta çojmë atë më përpara, edhe me diversifikimin e shërbimeve, edhe duke u futur në shërbimin elektronik dhe për të gjithë sfidat e tjera, që Posta Shqiptare ka përpara, siç e përmendi edhe i nderuari relator. Shumë faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Zoti Mziu e ka fjalën.

Xhelal Mziu – Të dashur kolegë,

Në fakt, Posta Shqiptare në këta 15 vjetët e fundit ka qenë në njëfarë mënyre një institucion, që e ka gjetur vetveten ndoshta më shpejt se institucionet e tjera dhe ka një gamë mjaft të gjerë shërbimesh ndaj qytetarëve, por duke iu referuar edhe njëherë kongresit të Stambollit, ose kongresit të 26-të, pavarësisht shpjegimeve që bëri qoftë kolegu Duraj, qoftë përfaqësuesja e ministrisë, akoma unë nuk arrita të kuptoj, nëse për shkak të këtij akti nënligjor që paraqitet, a do të ketë rritje të tarifës krahasuar me tarifën e sotme, sepse në atë përmendet edhe tarifa, përmendet edhe pesha, që do të thotë a shkojnë në aspektin e dëmit të konsumatorit, të qytetarit? Pra, a do të kemi një rritje të tarifës, apo për shkak të uljes së peshës mund të reflektohet përsëri?

Së dyti, Posta Shqiptare ka një gamë, që ka dalë madje edhe përtej funksionit të saj, siç janë shërbimet e ndryshme që ajo kryen, qoftë edhe me ndihmën ekonomike apo edhe të tjera shërbime. Kohët e fundit shoh që është rritur tarifa e shërbimit, kur paguan taksat, kur jepet një shërbim i ndihmës ekonomike e të tjera, pra janë rritur këto tarifa dhe duke qenë një ndërmarrje shtetërore, që është shpërndarë në mënyrë kapilare si askush tjetër, nuk besoj se duhet të tentojë të jetë një ndërmarrje fitimprurëse, por duhet të operojë fiks sipas kostos. Pra, në njëfarë mënyre kjo është mënyra më e mirë për t'u shërbyer qytetarëve. Kush është qëndrimi juaj dhe pse ka ndodhur kjo rritje tarifash?

E fundit, mos ka qenë ardhja me vonesë e kësaj rezolute, e këtij kuvendi, që u shkarkua drejtori i Postës Shqiptare, apo ka kryer ndonjë veprim tjetër, që akoma nuk është bërë mediatik, sepse ende ka ngelur enigmë largimi i tij nga Posta Shqiptare?

Për sa më sipër, do të doja një koment tuajin.

Arben Pëllumbi – Fjala është për ju.

Enkelejda Muçaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit, zoti Mziu!

Në lidhje me tarifën, edhe në kompletim të asaj që u diskutua, tarifën që vendosen dhe rregullohen janë tarifa të rregulluara në vlerën tavan në raporte tregtare ndërmjet 192 vendeve të Bashkimit të Përbotshëm Postar. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për tarifën tregtare ose tarifën që paguhet nga konsumatori në secilin vend në vendin tjetër, pra nuk bëhet fjalë as për rritje, as për ulje. Pra, nuk ka një ndryshim, madje, i nderuari relator sapo e përmendi, ne kemi nevojë sipas edhe konceptimit edhe me ndërhyrjen e autoritetit rregullator, që është AKEP-i. Parashtron Posta, si organi i vetëm publik që ofron këtë shërbim, që të mund të shkojë vërtet

drejt kostos shërbimi ynë, duke pasur parasysh rritjen e kostove që ne mund të kemi te pagesat tek të tretët, i nderuar zoti Mziu, dhe patjetër të ardhurat, ai është një bilanc që do të bëhet kërkesa për ndoshta kompensim të çfarëdolloj elementi humbës, që mund të kishte shoqëria, por kjo është pjesë e bilancit, i nderuar, që do të mund të vijë në momentin kur Posta do të mund të hartojë bilancin e vet dhe të kuptojë nëse në kuptimin e tarifave në dalje dhe tarifave në hyrje, që ka për këtë shërbim, si qëndron bilanci i veprimtarisë së vet.

Ndërkohë, është një operator patjetër publik dhe një nga funksionet kryesore, që është shërbimi universal, në këtë kuptim edhe nëse do të ketë një tarifë jo të orientuar drejt kostos për shërbimin universal, patjetër që këtu do të ketë nevojë për një politikë, e përmendi relatori, sesi do të mundet shteti shqiptar, qeveria shqiptare t'i vijë në ndihmë, bashkë me miratimin tuaj në fund, kompensimit të çfarëdolloj detyrimi shtesë që nuk është më i orientuar drejt kostos, por nuk kemi arritur akoma deri aty. Kështu që, në këtë kuptim ky proces nuk ndikon, pra nuk ka asnjë efekt në pagesat ndërkonsumatore, pra te konsumatori që paguan në lidhje me dërgesën e vet në vendin x.

Sa u takon çështjeve, apo ndryshimeve të tarifave të shërbimit, që ju përmendët, do të na duhet realisht të kuptojmë për cilat tarifa bëhet fjalë, i nderuar, pasi në kuptimin operacional Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë...

(Zoti Mziu ndërhyr pa mikrofon)

Ka një komision për pagesë?

(Zoti Mziu ndërhyr pa mikrofon)

Po, zoti relator...

Arben Pëllumbi – Është relator dhe ka të drejtë ta marrë fjalën në çdo moment.

Laert Duraj – Posta Shqiptare ka detyrim ligjor të ofrojë shërbim universal, pra paketën e dërgimit të letrave dhe të gjitha me radhë. Janë një sërë elementesh, për të cilat tarifat përcaktohen nga AKEP-i. Në këtë rast, siç e përmenda, Posta ka rreth 20 vjet që nuk i ka ndërruar këto tarifa.

Të gjitha tarifat e tjera, duke u bazuar në metodologjinë e orientimit drejtimit drejt kostos, kalojnë me miratimin e pronarit, që është Ministria e Ekonomisë në këtë rast dhe sigurisht ministria e linjës, Ministria e Infrastrukturës jep dakortësinë e vet.

Për sa i përket shërbimit financiar, tarifat nuk përbëjnë detyrim ligjor për të kaluar tek AKEP-i, por te ministria dhe këto bazohen e orientohen nga kostoja.

Në fakt, ju keni shumë të drejtë, një pjesë e tarifave të shërbimeve financiare janë shtuar, asnjëherë nuk kanë qenë 0, por kanë qenë 50 lekë, tani kanë shkuar 100 lekë. Kam parasysh tërheqjen e ndihmës në shërbimet postare. Kjo ka ardhur, flas, sepse e njoh me

detaje, për shkak të rritjes shumë të madhe të kostos, sidomos detyrimit që paga minimale të ngrihet, pra në Postën Shqiptare është rritur me rreth 20% fondi i pagave, e dyta, transporti i vlerave monetare për shkak të detyrimeve ligjore, pra është shtuar jashtëzakonisht shumë kostoja e vlerave monetare, së treti, kur operohet me bankat, besoj se kush merret me bankat e di qartë, *fee*-a e depozitimit dhe e tërheqjes, dhe Posta ka shumë veprime të kësaj natyre, është jashtëzakonisht e lartë, pra është shtuar shumë jo me përqindje, por me herë.

Të gjitha këto arsye dhe të gjitha këto shifra, që përmenda, janë marrë në konsideratë në metodologjinë e hartimit të tarifave dhe me të vërtetë, për mendimin tim, Posta e ka respektuar jashtëzakonisht shumë këtë metodologji të orientimit drejt kostove. Pikërisht këto elemente, që ju përmenda, zoti Mziu, janë ato që e kanë detyruar kompaninë të rrisë tarifat, gjithmonë ato tarifa, që nuk kemi detyrimin ligjor të marrim konfirmim te AKEP-i, pra që nuk ka Posta.

Thashë, që përfitoj nga fakti që e njoh kompaninë dhe dua të jem shterues në informacionet që jap, duke ndihmuar edhe koleget, pasi pas katër vjetësh atje, them se kam një informacion që mund të jetë i nevojshëm në këtë rast.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po, është dyfishuar tarifa nga 50 lekë në 100 lekë, por gjithsesi nëse është dyfishuar kjo tarifë, tarifat e tjera, që reflektojnë, janë dhjetëfishuar. Pra, më besoni që janë rritur jashtëzakonisht, sidomos të punosh me KESH-in sot është vërtet një stres dhe një mundim shumë i madh, jo vetëm për sa i përket punës, por edhe kostove që ka operacioni nga momenti i tërheqjes, pastaj në zyrë dhe në depozitim dhe me radhë. Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Më shumë për sqarim, kisha një pyetje të shkurtër. Ndarja e pensioneve është pjesë e shërbimit universal, apo është element shtesë?

Laert Duraj – Ndarja e pensioneve është një element shtesë, që bën Posta Shqiptare. Ka qenë një shërbim që nuk ka pasur një peshë të madhe për sa u përket transaksioneve, por në momentin e pandemisë, dhe unë gjej rastin të falënderoj të gjithë postierët e përfshirë në këtë proces, ky lloj shërbimi pati një trefishim, pasi njerëzit preferonin të mos rrinin në radhë për të shmangur rreziqet e grumbullimeve që dihen dhe kështu tani është kthyer në një shërbim me të ardhura të konsiderueshme për kompaninë. Në këtë rast është 100 lekë i gjithë procesi i dorëzimit të zarfit të pensionistit në shtëpi. Të paktën kaq ka qenë tarifa që Posta kishte, por aq duhet të vazhdojë të jetë.

Arben Pëllumbi – Zonja Zëvendësministre, kishit diçka për të shtuar?

Zoti Mziu, fjala është për ju.

Xhelal Mziu – Po të shkosh te një bankë e nivelit të dytë, që ka fiks funksion të saj tarifave të shërbimit monetar, qoftë arkëtim, apo pagesa, tarifa është 1 mijë lekë, ose 100 lekë të rinj. Posta Shqiptare është drejtoria me shpërndarjen kapilare më të madhe në Shqipëri dhe funksion të saj kryesor ka shpërndarjen e postës. Të gjitha funksionet e tjera janë dytësore, që do të thotë se godinat i ka shtetërore, ose më saktë janë të akomoduar kudo, ka sistemin e adresave më të madh se askush tjetër dhe është absolutisht e papranueshme që një pensionist të paguajë 1 mijë lekë për pensionin e tij, kur 1 mijë lekë është edhe nëse shkon te banka e nivelit të dytë, apo për të dhënë ndihmën ekonomike. Kostoja është minimale, sepse janë me mijëra njerëz që shkojnë, kryhen shërbimet dhe tarifa që përfitohet brenda ditës është shumë më e madhe. Jo vetëm që nuk kemi të bëjmë me kosto, por është një tarifë marramendëse me përfitime të jashtëzakonshme.

Tjetër, duke marrë shkas nga kjo, në zgjedhjet e vitit të kaluar në qarkun e Dibrës postierët ishin personat me rrezikshmërinë më të lartë, që unë kisha në zonë. Nën petkun e çuarjes së pensione në shtëpi, merrnin një zarf, fusnin pensionin dhe nuk e di çfarë mund të fusnin tjetër, në aspektin e fushatës dhe e çonin nëpër shtëpi. Mua nuk më duket aspak normale që një postier të çojë pensionet në shtëpi, në asnjë vend të botës nuk ndodh. Janë bankat, bankomatet që kryejnë shërbimet. Është e papranueshme që dikush të dërgojë ndihmën ekonomike dhe pensionin, e para, për koston dhe, e dyta, sepse përdoret politikisht, në aspektin e zgjedhjeve, sepse është shtuar tej mase numri i tyre në këtë sektor.

Arben Pëllumbi – Zoti Mziu, unë ju lashë ta parashtronit pyetjen dhe mendimin tuaj, por në fakt kjo temë nuk është pjesë e këtij diskutimi sot. Kjo që po diskutojmë sot nuk ndikon në tarifave të brendshme. Kjo që aprovojmë ne sot, me sa kuptova, ndikon në tarifave që shërbimi postar ka me homologët e tij jashtë kufijve të vendit. Gjithsesi, unë thashë do ta kemi këtë diskutim, kur të vijë AKEP-i, por meqë zoti Mziu e shtroi, ju lutem, një përgjigje nga ana juaj.

Laert Duraj – AKEP-i nuk diskuton pjesën e tarifave të shërbimit financiar. Janë rreth 500 mijë pensionistë dhe duhet të kuptojmë që tregu është liberalizuar, çdo pensionist zgjedh ta marrë pensionin në postë, ose në bankë. Pra, ai nuk është i detyruar, sepse posta nuk është monopol.

E dyta, kur pensionistët vijnë pranë Postës Shqiptare, nuk diskutohet që tarifave i kanë 0. Tarifa prej 100 lekësh është kur ata e kërkojnë pensionin në shtëpi. Të shkojë një pension në shtëpi, në një fshat apo qytet të largët ka një kosto të caktuar.

Për sa u përket ndihmave ekonomike, në përgjithësi, rreth 80% e bashkive, sepse edhe ky është treg i lirë, i ndajnë vetë nëpërmjet sporteleve të tyre, një pjesë akoma më e madhe

zgjedhin Postën Shqiptare, por tarifa e terminimit, ose *fee*-a, paguhet nga bashkia përkatëse, për shembull, rasti i Tiranës. Vetëm në shumë pak raste janë klientët apo ata që përfitojnë ndihmën, që marrin këtë tarifë në Postën Shqiptare. Këtë e përmenda për sqarim.

Për sa u përket postierëve të Dibrës, atje ju keni fituar dhe nuk e di se çfarë kanë pasur në zarfe ata.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aq ka qenë maksimumi, kështu që kjo është për humor mes kolegësh.

Gjithsesi, tarifat e shërbimit financiar, siç e tha edhe kryetari, nuk janë pjesë e këtij diskutimi dhe asnjëherë nuk përfshihen në vendimet e kongreseve të UPU-së, që shpresoj të ratifikohen sa më shpejt. Faleminderit!

Helidon Bushati – Për efekt të diskutimit, ju thashë që është një fushë që shumë pak e njohim. Ju e njihni, sepse keni pasur eksperiencë, por shumica e kolegëve nuk e njohin, ndaj kam një pyetje për të ardhurat nga çmimet e rregulluara. Pra, për disa tarifa posta është e detyruar që të marrë miratimin e AKEP-it, si për tarifën e energjisë të ERE-s apo tarifën e ujit të ERRU-së, ndërsa për disa tarifa të tjera janë të derregulluara dhe nuk ka detyrim për të marrë miratim...

Laert Duraj – Merr miratim te pronari.

Helidon Bushati – Tek asambleja po, sepse e merr nëpërmjet bordit, por kjo nuk diskutohet, sepse është mënyra se si funksionon një sh.a.

Pyetja ime është: sa përqind të të ardhurave të përgjithshme të postës vijnë nga shërbimet e rregulluara dhe sa nga të parregulluarat, cilado qofshin ato? Nuk është e thënë të më jepni një shifër të saktë, por pak shumë.

Arben Pëllumbi – Po, zoti Duraj.

Laert Duraj – Atëherë, postari dhe finansiari ndahen në raportet 55% me 45%. Pra, 55% e të ardhurave të Postës Shqiptare janë nga shërbimi postar dhe 45% janë nga shërbimi financiar, pra për pensionet e të gjitha këto me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rreth 80% e të ardhurave të shërbimit postar vijnë nga shërbimet e rregulluara, për të cilat ju flisni. Pra, shërbimi universal në total, edhe me terminime e të gjitha, vjen ga të rregulluarat dhe pjesa tjetër janë ato të parregulluara, që kanë të bëjnë me shërbimin ekspres që ka Posta Shqiptare, marrëveshjet që posta ka për dërgimin e pakove të shpejta, të cilat, në njëfarë mënyre, janë jashtë shërbimit standard universal.

Helidon Bushati – Domethënë, janë 55% me 45%, nga 55% në 80%, por ja po themi 50% me 50% nga çmimet e rregulluara me çmimet e parregulluara për sa u përket të të

ardhurave. Sa e ka *turnover*-in vjetor Posta Shqiptare? Edhe për këtë nuk kërkoj një shifër të saktë, por pak a shumë.

Arben Pëllumbi – Fjala për ju, zonja Malolli.

Irena Malolli – Nëse mundem, do t'ju bëj një shpjegim teknik. Është e drejtë ajo që shpjegoi edhe kryetari që kemi të bëjmë me rregullimin e shërbimeve postare dhe rregullimi i shërbimeve postare, që rregullohet me ligjin nr. 46/2015, ka në fokus shërbimet postare në Republikën Shqipërisë, duke i klasifikuar në shërbime bazë ose universale postare dhe ato që janë jashtë kësaj kategorie. Në ofrimin e shërbimit bazë apo universal postar operon Posta Shqiptare dhe në këtë segment të tregut është nën rregullim, që do të thotë se shërbimet bazë postare janë të mbikëqyrura edhe për pjesën e tarifës.

Një shqetësim shumë i drejtë, i ngritur në vijimësi nga Posta Shqiptare, është që tarifat e kësaj kategorie të shërbimit bazë postar, që përfshijnë postat e letrës nga 0 deri në 2 kilogram, pakot postare të vogla, koltë postare deri në 10 dhe 20 kilogramë, janë me çmime të rregulluara me një vendim qeverie të vitit 2003 dhe kanë mbetur të pandryshuara në të gjithë këtë hark kohor edhe me sfidat që i është dashur Postës Shqiptare, në veçanti në pjesën e COVID-it, të përballet. Pse është bërë kjo? Kjo është bërë për të mbrojtur konsumatorin nga çmimet e larta.

Mënyrat se si kompensohet kostoja neto e shërbimit universal, që është një e drejtë e ligjshme e ofruesit të shërbimit universal postar, janë disa dhe ligji i ka të parashikuara, ku deri në vitin 2017 ato ishin në zonën e rezervuar kur Postës Shqiptare i jepej e drejta për të ofruar shërbim në zonën e rezervuar që kishte kategorinë e letrave postare deri në 100 gram dhe 50 gram. Më tej, ligji ka parashikuar instrumentin me skemat e ndihmës shtetërore apo forma të tjera të ligjshme të kompensimit të kostonet. Ajo që unë dua të sqaroj është se Posta Shqiptare është e detyruar t'i mbajë zyrat postare në të gjithë territorin e vendin me disa përcaktime gjeografike mbulim popullsie, edhe kur nuk ka shërbim, në 5 ditë të javës, pa ndërprerje të shërbimit dhe për të gjitha këto ka kosto shtesë, për të cilat i lind e drejta e kompensimit.

Për sa i përket pjesës tjetër të shërbimeve, është e drejtë që ka pasur një zhvillim dhe një dinamikë shumë pozitive, si dhe një progres për ta përshëndetur Postën Shqiptare për zgjerimin e gamës së shërbimeve jo vetëm me shërbimet postare, por dhe ato jopostare, që janë shërbimet financiare çobankë, për të cilat ofron një shërbim shumë të dobishëm për të gjithë qytetarët kur nuk kemi prezencë të bankave. Për këtë ka rregullim specifik ligjor që nuk mund të japim përgjigje, sepse nuk jemi ne që mbulojmë, për të mos bërë ndonjë gabim në shpjegimet që dhashë, por relatori e tha saktë.

Helidon Bushati – Dua një informacion për atë që pyeta unë, se unë zakonisht di se çfarë pyes dhe se ku dua të arrij nga pyetjet që bën. Pyetja ime ishte: sa është *turnover*-i i Postës Shqiptare në vit? Në qoftë se nuk e dini ju, mund ta dijë ish-drejtori dhe po e them pa të keq këtë gjë.

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, bëni të gjithë paketën e pyetjeve që të mos e bëjmë kështu pyetje-përgjigje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Laert Duraj – Atëherë, në vitin 2017 ka qenë rreth 2 miliardë lekë dhe në vitin 2021 pak më shumë se 3 miliardë.

Helidon Bushati – Domethënë, 30 milionë dollarë.

Laert Duraj – Po.

Helidon Bushati – Tani, ku desha të dilja unë. Ka 30 milionë dollarë *turnover*-i komplet, ku 15 milionë janë nga çmimet e rregulluara, pak a shumë, me ndonjë diferencë të vogël pranohet. Atëherë, meqenëse po flasim për qytetarët dhe për nevojën që të mos ngarkohen qytetarët, se ky është problemi kryesor, por këtë diskutim do ta bëjmë me AKEP-in, çdo shoqëri aksionere, pasi hiqen të gjitha shpenzimet e tjera, ka nevojë për një rezervë zhvillimi, për atë pjesën e investimeve dhe pjesa tjetër shkon për dividend. Dividendi në rastin e shoqërive aksionere shtetërore i derdhet shtetit. Normalisht, kjo është për analogji me sistemin energjetik, vendoset një çmim i energjisë elektrike, i cili lidhet me nevojat për zhvillim, me nevojat për investime, ku nuk është prioritar dividendi për shtetin. Pyetja për ju dhe për postën është: meqenëse investimet kryesore janë bërë (ajo që thatë ju është krejtësisht e vërtetë që ka filluar që në vitet 2006-2007 përmirësimi rrënjësor i shërbimit postar, ka filluar fiks në vitin 2006), pra ato që quhen investime kapitale janë bërë nga më të ndryshmet, a është e mundur që të aplikohet nga Posta Shqiptare çmime në zbritje për qytetarët, meqenëse po rritet gama e shërbimeve, rriten të ardhurat, investimet kapitale janë bërë, në mënyrë që të u shkaktojmë dhimbje koke drejtorit aktual apo atyre që do të vijnë për të shpikur se çfarë lloj tenderësh bëhen për të shpenzuar këta 30 milionë dollarë? A mund të kërkohet nga AKEP-i, që ne do t'ia kërkojmë AKEP-it, pa dyshim, që të shikohet mundësia e uljes së tarifave të rregulluara, sepse kjo është edhe një shtysë që drejtorët në vazhdimësi të shpikin shërbime të reja dhe të rrisin eficiencën e postës?

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, unë ju thashë edhe në fillim që nuk e kemi temë të diskutimit sot. Kur të vijë AKEP-i këtu që ne do të diskutojmë raportin vjetor të tyre, e hapim këtë diskutim. Përfaqësuesit e ministrisë do të jenë, zoti Duraj përsëri do të jetë relatori i kësaj çështjeje dhe mund të diskutojmë. Ne sot nuk po diskutojmë për këtë çështje, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe unë këtë doja të thosha që, kur të kemi raportin e AKEP-it, të kemi edhe disa të dhëna statistikore në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e Postës Shqiptare për të diskutuar për këtë temë. Nga ajo që kuptova unë, kemi 20 vjet që ne nuk e ndryshojmë çmimin, pra as nuk e kemi rritur dhe as nuk e kemi ulur, është çmimi i vitit 2003. Nëse do të mund ta ulim atë çmim, unë nuk e di, por di një gjë që ne kemi disa vjet rresht që i kërkojmë AKEP-it që duhet t'i kërkojë Postës Shqiptare dorëzimin në adresë të kolipostës, të cilën ende Posta Shqiptare nuk e ka bërë dot për shkak të të ardhurave që ka nga ky zë postar. Pra, ne kemi çështje për të diskutuar, por kur të vijë AKEP-i, ndërsa sot jemi për marrëdhëniet e Postës Shqiptare me shtetet e tjera për të ardhurat, që, me sa kuptova, janë pozitive, sepse ne si vend i vogël na influencojnë pozitivisht nga Kongresi i Stambollit.

Atëherë, e hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016”? Kundër? Abstenim?

Miratohet me unanimitet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi.

Faleminderit!

Ta gëzojë Posta Shqiptare terminimin, sipas Kongresit të Stambollit!

Irena Malolli – Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Faleminderit, zonja Malolli!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.4.2022, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Tatiana Piro, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Rrahman Rraja, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Nusret Avdulla dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Luljeta Bozo, Flamur Hoxha dhe Fatjon Veizaj.

Arben Pëllumbi – Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës.

Ne kemi dëgjuar raportin e mbajtur nga kryetari i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, ku kemi diskutuar me të. Ai pasnesër do të jetë edhe pjesë e seancës plenare, ndërsa sot kemi draftrezolutën që Kuvendi i Shqipërisë duhet të miratojë në lidhje me aktivitetin e ERE-s dhe detyrat që ne i kemi lenë për vitin e ardhshëm 2022.

Relator është zoti Anduel Tahiraj. Materiali ju ka ardhur në postën elektronike, nga të gjithë kolegët sugjerimet kanë qenë të mirëpritura, kështu që draftrezolutën do ta lexojë tani zoti Tahiraj dhe më pas, nëse dikush ka diçka, mund ta thotë.

Anduel Tahiraj – Përshëndetje të gjithëve!

Draftrezoluta për sa i përket vlerësimit të veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021, duke njohur Entin Rregullator të Energjisë, si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor; duke theksuar trendin pozitiv të uljes së nivelit të humbjeve në rrjet në sistemin e energjisë elektrike nga viti në vit; njëkohësisht edhe rritjen e arkëtimeve, të cilat për vitin 2021 kanë shkuar në 97,4%; përpjekjet e vazhdueshme, megjithëse me vonesë, për krijimin e Bursës Shqiptare të energjisë elektrike ALPEX. sh,a, e cila është një platformë elektronike e krijuar, së pari, për tregun Shqipëri-Kosovë dhe më pas do të zgjerohet edhe në tregun rajonal, shpresojmë brenda 6 muajve të këtij vitit të jetë funksionale, Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2021 vlerëson:

- Punën e Entin Rregullator të Energjisë për ndarjen funksionale të OSHEE-së, si hap i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në liberalizimin e tregut të energjisë elektrike dhe hapjen e mëtejshme të tij.

- Punën e bërë nga Enti Rregullator i Energjisë për njohjen reciproke të licencave në veprimtarinë e tregimit dhe furnizimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, pra në marrëveshjen e bërë me rregullatorin e Kosovës.

- Punën e bërë nga Enti Rregullator i Energjisë për zgjidhjen e ankesave, trajtimin e çështjeve të ndryshme dhe problematikave të konsumatorëve.

- Punën e bërë nga Enti Rregullator i Energjisë për bërjen funksionale të tregut të balancimit të energjisë elektrike,

– Punën e bërë nga ERE-ja për vlerësimin e kuadrit rregullator dhe ligjor, duke përfshirë edhe tarifimin e shërbimeve që vijnë nga përdorimi i teknologjive të reja, siç është rasti i stacioneve të ngarkimit të automjeteve elektrike.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 rekomandon:

1. ERE-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorët e tjerë në fushën e energjisë të luajë një rol aktiv në hartimin e një plani konkret, për të bërë të mundur lehtësimin e barrierave, promovimin, si dhe incentivimin e impianteve të vetëprodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme, veçanërisht nga dielli dhe era, si për bizneset e mëdha prodhuese.

2. Duke pasur parasysh çmimet e larta të energjisë dhe zhvillimet më të fundit në tregun global të energjisë ERE, në bashkëpunim me të gjithë aktorët në këtë fushë, të japë kontributin e saj për të bërë të mundur forcimin e mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë, si dhe ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor.

3. ERE-ja të vijojë intensivisht në përcaktimin e metodologjisë së çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit, si dhe të luaj një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për zgjidhjen e problematikave që lindin nga instalimi i burimeve të vogla të rinovueshme, për shembull, problemi i mënyrës së trajtimit të netimit nga ana e OSSH-së e të tjerë.

4. ERE-ja të kërkojë impenjim maksimal nga të gjithë aktorët për të bërë të mundur që brenda vitit 2022 operimi i bursës të jetë funksional.

5. ERE-ja të vijojë mbështetjen me ekspertizën teknike për të bërë të mundur ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, si një projekt shumë i rëndësishëm, sidomos në këtë periudhë kur çmimet e energjisë elektrike kapin vlera stratosferike.

6. Ne faqen zyrtare të ERE-s në internet duhet që linku/grafika “Bëj një ankesë” dhe numri i gjelbër në dispozicion të qytetarëve/konsumatorëve të jenë në faqen kryesore.

Sot për sot, shoh si problemin më të madh mbifaturimin, që duhet të jetë në vëmendjen e të gjithë faktorëve për vitin 2022.

ERE të vijojë të kërkojë mundësinë e instalimit gradual të matësve inteligjentë, bazuar në një analizë kosto-përfitim dhe të mbulimit me rrjetin e telekomunikacionit, pasi, veç të tjerash, përmirëson cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit, duke evituar problematikat e mbifaturimit dhe ankesat e konsumatorëve. Fakti që për vitin 2021 ankesat me objekt “mbifaturim të energjisë elektrike” janë rritur krahasuar me një vit më parë, është një problem të cilin ERE-ja për këtë vit duhet ta ketë në objektivat kryesore të saj.

Gjithashtu, ERE-ja, në bashkëpunim me Agjencinë e Eficiencës, duke iu referuar edhe praktikave më të mira ndërkombëtare, të punojë për sensibilizimin e konsumatorit, mbi të

gjitha, për përdorimin eficient të energjisë elektrike, çka përkthehet në kursim energjie dhe më pak kosto për vetë konsumatorin.

ERE duhet të vijojë të monitorojë me rigorozitet problematikat që kanë lidhje me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë zbatimin e detyrave që rrjedhin për FSHU-në, në përputhje me vendimin e bordit të ERE-s për rishikimin e planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike.

Gjithashtu, për vitin 2022, ERE-ja të miratojë dhe të fillojë zbatimin e rregullores për masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE-ja të performancës së shërbimit ndaj klientit, si një hap i rëndësishëm, që ndikon në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me standarde për konsumatorin.

Pak a shumë, këto janë rekomandimet dhe objektivat edhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por edhe të ERE-s për vitin 2022. Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Tahiraj!

A ka diçka për të shtuar nga kolegët?

Atëherë, e hedhim në votim. Kush është dakord me...

Po, zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Unë e lexova draftrezolutën. Edhe në komunikimin që kishim, kur ishte i pranishëm drejtori i ERE-s, ne kishim disa shqetësime, të cilat, edhe nëse nuk gjetën zgjidhje aty, them që të paktën duhet të jenë pjesë e rezolutës. Pra, ERE është enti kryesor ligjor, që përcakton çmimin e energjisë elektrike mbi bazën e kostos. Po ta shohësh, këto ditë thuhet se do të futet fasha e energjisë elektrike.

Çfarë ka ndryshuar? Sepse ne e prodhojmë pothuajse të gjithë sasinë e energjisë elektrike që konsumojmë. Aq më tepër, po ta shohësh, më shumë se 60% e asaj që prodhohet në Shqipëri është shtetërore, por edhe nga kontaktet që kam pasur me kompanitë private, që kanë HEC-et e vogla dhe ato të mëdhatë, janë fitimprurëse. Madje, në 5 apo 6 vjet ato rikthejnë të gjithë investimin fillestar të tyre.

Pra, cila është arsyeja e rritjes? Sepse ne e përballojmë. Pse të vendosë qeveria dhe të mos vendosë ERE-ja?

Së dyti, po bëhen investime, të cilat sot nuk janë eficiente. Unë e thashë edhe herën e kaluar dhe po e them edhe tani. Po të shohësh buletinin në datën 12 maj, 10 miliardë lekë është tenderi për matësit që do të vendosen në të gjithë Shqipërinë.

Arben Pëllumbi – Zoti Mziu, nuk dua t'ju ndërpres, se nuk e kam në natyrë, por nuk kemi më diskutim për rezolutën, e kemi bërë diskutimin.

Xhelal Mziu – Kush e ka bërë rezolutën?

Arben Pëllumbi - Në rast se ju keni një propozim konkret...

Xhelal Mziu – Po pra, këto janë propozimet.

Arben Pëllumbi – Fjalinë, ku e dëshironi, në cilën pikë dhe çfarë dëshironi. Ne do ta hedhim në votim, nëse pranohet apo jo. Nuk mund ta bëjmë më diskutimin, se kemi bërë.

Xhelal Mziu- Fjalja e parë, meqenëse e do kështu: “Çmimin duhet ta vendosë Enti Rregullator dhe jo qeveria”.

Arben Pëllumbi – Në cilën pikë dëshironi ta bëni këtë ndryshim?

Xhelal Mziu – Vendoseni ku të doni ju, se ju e keni përpiluar.

Arben Pëllumbi – Ne e kemi përpiluar, por jua kemi dërguar në *email*-et tuaj, kemi pritur sugjerimet tuaja. Nëse nuk e keni çuar përpara, sot duhet të thoni: “Në këtë pikë mendoj se kjo fjali duhet të shtohet kështu ose të shtojmë një pikë më vete”.

Xhelal Mziu – Pse, është i kufizuar numri i pikave?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pikë më vete.

Arben Pëllumbi – Formulojeni, se duhet ta hedh në votim.

Xhelal Mziu – “Enti Rregullator duhet ta vendosë çmimin dhe jo qeveria”. Kjo ishte pika e parë.

Së dyti, a nuk do të ishte normale të vendosej prapë një pikë e dytë? Sot janë me qindra familje që nuk kanë energji elektrike. Të mohosh produktet më kryesore, siç janë uji, energjia apo ajri, vetëm këtu mund të ndodhë! Të mos ketë asnjë familje pa energji elektrike, pavarësisht të ardhurave ekonomike që ato kanë. Pra, të gjendet një modul (e paguan qeveria, e paguan OSHEE-ja apo dikush tjetër), por të mos ketë në vitin 2022 familje pa energji elektrike.

Unë mund t’ju sjell një listë me qindra familje në qarkun e Dibrës, që janë pa energji elektrike prej vitesh, jo prej muajsh.

A nuk është normale të kërkohet kjo dhe të gjendet një zgjidhje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Së treti, pse të shkojnë 10 miliardë në këtë periudhë krize për të vendosur matësit inteligjentë? Mjaftojnë ata që janë, sepse jemi vërtet në kushte jonormale dhe vlera 10 miliardë le të shkojë për kompensimin e këtyre familjeve apo për ndonjë investim tjetër.

Pra, këto janë pikat, që unë them se duhet të gjejnë vend në këtë rezolutë.

Arben Pëllumbi – Atëherë, t’i marrim me radhë. Propozimi i parë juaji...

Xhelal Mziu – Enti Rregullator ta përcaktojë çmimin real dhe jo qeveria.

Arben Pëllumbi – Enti Rregullator përcakton, por propozimet sigurisht që i shkojnë nga qeveria, se ajo është pronarja e sistemit.

Xhelal Mziu – Ai propozon dhe jo qeveria. Qeveria ka propozuar...

Arben Pëllumbi – Qeveria propozon dhe në fund vendos Enti Rregullator. Kjo është e drejtë ligjore. Kështu funksionon.

Xhelal Mziu - Ju e trajtoni Entin Rregullator si sekretari. Enti Rregullator është i vetmi institucion legjitim për përcaktimin e...

Arben Pëllumbi – Enti Rregullator përcaktohet me ligj. Këtë ligj e kemi bërë ne këtu. Prandaj enti vjen dhe jep llogari para nesh. Ne nuk mund t'i themi Entit Rregullator që të zbatojë ligjin, se e ka për detyrë ta bëjë këtë. Pra, propozuesi është pronari i sistemit, që në këtë rast është qeveria shqiptare. Ai që merr vendimin final për tarifën është Enti Rregullator. Kështu funksionon.

Xhelal Mziu – Është vendosur rritja e tarifës për ngarkesën mbi 700 kilovatë.

Arben Pëllumbi – E para, nuk është vendosur, se nuk është bërë akoma propozim.

E dyta, cilëndo qeveri, në këndvështrimin tim, i lind e drejta të bëjë propozime, sipas situatës në të cilën ndodhet. E pranon apo nuk e pranon Enti, është për të pastaj.

Xhelal Mziu – Ka vetëm një ndërhyrje. Në qoftë se qeveria do ta ulë tarifën poshtë koston dhe të marrë përsipër dëmin, ndërhyr. Në të kundërt, Enti Rregullator është ai që përcakton çmimin final, që kjo është kostoja reale dhe kjo do të jetë tarifa. Pra, qeveria mund të ndërhyjë, nëse do të japë ndonjë mbështetje për fashat e ndryshme, por jo për ta rritur mbi koston.

Arben Pëllumbi – Kush është dakord me propozimin e zotit Mziu, që të shtojmë një pikë, ku t'i sugjerojmë Entit Rregullator të Energjisë të mos pranojë propozime nga qeveria, por t'i vendosë vetë çmimet?

Janë 5 vota pro.

Kush është kundër?

Propozimi i parë bie poshtë dhe nuk pranohet.

Propozimi i dytë.

Xhelal Mziu – Propozimi i dytë: anulimi i tenderëve të blerjes së matësve inteligjentë, që i kushtojnë buxhetit të shtetit më shumë 10 miliardë lekë. Këto para të mos shkojnë për t'i bërë qejfin ndonjë biznesmeni, por të shkojnë ose në uljen e tarifës, ose për të bërë investime në zonat ku janë telat me gjemba ose kabinat e vendosura në terren të hapur si rrezik real për qytetarët.

Arben Pëllumbi – Pavarësisht faktit që u përpoqa të shpjegoj që jemi në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese dhe i sugjerojmë ERE-s, ERE nuk bën as tenderë, as nuk blen matës. ERE vetëm vendos tarifa, në këndvështrimin tim, nuk u imponon dot kompanive të bëjnë apo të mos bëjnë tenderë. Gjithsesi, ju keni një propozim konkret dhe unë jam i detyruar ta hedh në votim.

Kush është dakord me propozimin e sapo bërë nga zoti Mziu? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk pranohet propozimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sqarimi i votës...

Helidon Bushati – Enti Rregullator kalon programet e zhvillimit ekonomik, siç quhet, të shoqërive aksionere, sidomos të OST-ës e OSHEE-së. I kalon Enti Rregullator çdo vit, sepse kanë lidhje dhe me çmimin e energjisë. Këtu hyjmë në një debat të gjatë.

Ajo që thotë kolegu Mziu është që të mos bëhen tenderë për shpenzime parash të kota. Ne nuk jemi kundër vendosjes së matësve inteligjentë. Kjo ka qenë edhe në draftrezolutat e viteve të mëparshme, ka qenë një nga detyrat kryesore të OSHEE-së. Problemi është që po bëhen 10 miliardë lekë të vjetër investim në *smart meter* në tri qytete, të cilët nuk do të funksionojnë si *smart meter*. Për t'ju shpjeguar, është një sahat elektronik, nga ata që tregojnë vetëm orën, me një nga orët që kanë kolegët dhe ne, që është *smart* dhe bën edhe lidhjen me celularin e të tjera. Po blihen aparatura, që do të tregojnë përsëri se sa energji ke harxhuar, por nuk do të bëjnë transmetim të dhënash.

Cila është ideja e *smart meter*-ave? Ideja është që të mos ketë nevojë të vijë personi, individi, për të parë se sa energji elektrike ke harxhuar, por vetë aparatura i dërgon të dhënat në një sistem qendror tek OSHEE-ja dhe nxjerr faturën, nëpërmjet sistemit të *billing*-ut. Kështu që edhe ulet numri i punonjësve, edhe rritet siguria, që ti të paguash për aq sa ke konsumuar. Sot po harxhohen 10 milionë dollarë, 10 miliardë lekë për të blerë sahatet, që do të bëjnë të njëjtën punë me sahatet që kemi ne aktualisht. Kaq. Është e thjeshtë fare!

Pra, ajo që u propozua ishte që t'u thuhej stop abuzimeve. Mendoj se kjo ishte ideja kryesore e zotit Mziu.

Prandaj, pyetja që duhet t'u bëj kolegëve, qoftë edhe për efekt të procedurës dhe të protokollit është: a jemi dakord të vendosim në draftrezolutë që ERE të ndalojë abuzimet me tenderë në sistemin elektroenergjetik?

Kjo është pika në draftrezolutë.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Bushati, për shpjegimin që dhatë!

Në fakt, sikurse e thashë edhe në pikën e parë, ne nuk mund t'i sugjerojmë një enti apo një organi që të zbatojë ligjin, sepse e ka detyrë të zbatojë ligjin dhe, nëse shikon shkelje, të bëjë detyrën e saj, ashtu sikurse e përcakton ligji.

Gjithsesi, propozimi i zotit Mziu nuk u aprovua.

Hedhim në votim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, propozimin tjetër.

Xhelal Mziu – Jam i sigurt që edhe këtë nuk do ta shihni fare, por do ta trajtoni vetëm politikisht. Enti Rregullator nuk është vetëm thjesht sekretari.

Enti Rregullator duhet të ndërhyjë në të gjitha termat makroekonomikë të atij institucioni, për të orientuar investimet, për fuqinë punëtore, për përcaktimin e kostos reale dhe shumë standarde të tjera që ajo ka. Po të shohësh, OSHEE-ja sot ka një rritje drastike të numrit të të punësuarve në këtë sektor...

Arben Pëllumbi – Zoti Mziu, propozimin konkret, ju lutem, se si dëshironi ta shkruajmë fjalinë këtu! Ta lëmë diskutimin, ta lëmë politikën.

Xhelal Mziu – Që të të orientoj ty, zoti kryetar, dhe kolegët e mi, do të bëj hyrjen për të shkuar te propozimi.

Arben Pëllumbi – Nuk ka nevojë për hyrjen se e kemi bërë, bëni propozimin.

Xhelal Mziu – Sot kostoja reale e energjisë elektrike është rritur në mënyrë artificiale. Për ta ulur këtë kosto, edhe për shkak të luftës, siç thotë dhe Kryeministri që jemi në luftë, propozoj që në rezolutë të shkruajmë: “Brenda vitit duhet shkurtuar jo më pak se 30% e fondit të pagave”. Pra, ose të ulen pagat, ose të ulet numri i punonjësve të cilët thyejnë çdo rekord në raport me 1000 kontrata për abonentë. E shoh të udhës që të jetë pikë kryesore ulja e numrit të të punësuarve apo ulja e vlerës që shkon për pagat e punonjësve.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Mziu!

Kush është dakord me propozimin e zotit Mziu, që të shtojmë në rezolutë këtë propozim për ERE-n, që të shikojë numrin e punonjësve në kompanitë e transmetimit të energjisë elektrike?

Kundër?

Propozimi nuk aprovohet.

Atëherë, kush është dakord me draftrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021”, që e keni përpara dhe u lexua nga relatori?

Kundër? 5 vota kundër.

Miratohet.

Faleminderit për kontributin, kolegë!

MBYLLET MBLEDHJA